

LETRA E FRETËRVE TË PULTIT (1761) DHE VENDI I SAJ  
NË KULTURËN E SHKRIMIT SHQIP NË MES TË SHEK.  
TË 18-TË

**Qerthulli problematik dhe diskutimi përkatës**

Hulumtuesi italo-arbëresh Italo Sarro po befason në mënyrë të përsëritur rrethet intelektuale e ato shkencore albanologjike, duke botuar informacion në varg mbi praninë e një dokumentacioni historik sa të vlefshëm aq edhe të vëllimshëm që gjëllin sot e gjithë ditën ende i pashfrytëzuar në arkivat e Vatikanit<sup>1</sup>. Si gjetje të pazakonshme arkivore dallojmë gjithsesi debutimin i tij në faqet e “Hyllit të Dritës” (2007a) me një letër italisht-shqip, që datohet aty nga fillimet e viteve 60-të të shek. të 18-të e që mban firmën e fretërve françeskanë (të vegjël) në Dioqezën e Pultit. Si nxitës i punimit tonë shërbeu pikërisht kjo letër, shi pjesa e tekstit shqip, hulumtimi filologjik i së cilës rezultoi të jetë disavlerësh: a) së pari, ajo përcjell një ndër të paktat dëshmi të kohës, kur shqipja e shkruar mëton funksione të reja si mjet komunikimi ndërinstytucional, madje në marrëdhënie me instanca të tilla të larta siç ishin atëbotë pushteti vendor i Portës së Lartë; c) së dyti, interpretimi filologjik i tekstit lejon të përditësohemi me shkallën e zhvillimit të shqipes së shkruar në arealin kulturor të Veriut në mes të shek. të 17-të; c) së treti, interpretimi i tij gjuhësor na mundëson të identifikojmë si veçoritë e gjuhës së autorit, ashtu edhe bazën dialektore të mjedisit gjuhësor, ku vepronte ai.

Përcollëm kështu përmbledhtas qerthullin problematik që synojmë të shtjellojmë dhe të nxisim në këtë studim. Pas një skicimi të thukët të sfondit historik-kulturor-fetar të dioqezës së Pultit në shek. e 18-të si edhe të rrethanave që kushtëzuan përpilimin e letrës, do të ndalemi shkurt në ndonjë çështje ende të pasqaruar që lidhet me kohën e hartimit të saj, me instancën administrative-ushtarake

---

1 Sarro: Scutari e la sua Diocesi intorno al 1750, në: *Hylli i Dritës* (= HD) 1 [2006] 68-81; Letër e Fretënve të Pultit drejtue në vitin 1762 pashës së Shkodrës, në: HD 2 [2007] 163-164; Francescani nelle diocesi di Scutari e di Pulati nella seconda metà del XVIII secolo, në: HD 4 [2007] 36-62; Missionari francescani nella Diocesi di Pulati e l'incendio di Sciosci, në: HD 2 [2008] 70-86.

apo vetë personin, të cilit i drejtohet kjo letër; për më tepër nuk do të mungojnë as përsiatjet e arsyeve që mundësuan hartimin e (një pjese të) tekstit edhe në gjuhën shqipe. Një qëllim tjetër që i kemi vënë vetes në këtë punim është ribotimi i tekstit shqip me aparatën e nevojshëm kritik, çka parakupton njëkohësisht edhe shtesimin e zgjidhjen e disa problemeve që ngërthejnë, ndër të tjera: zbërthimi i kodit alfabetik, rregullat ortografike të zbatuara në të, si edhe vendi që zë ky tekst në kulturën e shkrimit shqip me alfabet latin në mes të shek. të 18-të.

## II. Letra dhe sfondi i saj kulturor-historik.

### 1. Dioqeza e Pultit në shek. e 17-të (prej Peter Bartl)

Pulti është dioqeza më e skamur (*più misero*) në tërë provincën e Arbënisë. Kështu shkroi më 1703 arqipeshkvi Vinzenz Zmajević në relacionin e vizitës së tij pastorale në Shqipërinë e Veriut. E gjithë krahina ngjizej prej malesh dhe shkëmbinjsh të pakalueshëm. Vetëm në kufi me mbretërinë e Serbisë dirgjej një rrafsh i vogël; përndryshe i gjithë vendi ishte i papëlleshëm. Rrugët ekzistonin sa për emër, ndërkohë që lumenjtë dhe përrenjtë nuk mund të përshkoheshin dot me kuaj. Tërë krahina të ndillte një ndjenjë mohëse, përpos cilësisë së ujit të pijshëm, për të cilin arqipeshkvi mundi të qëmtonte fjalë lëvduese.<sup>2</sup> Një shënim i vitit 1744/45 na kumton gjithashtu hamendjen, se dioqeza rrokte dikur edhe rrafshinat përçark, veçse në to gjëllinin ndërkohë turqit, d.m.th. besimtarët myslimanë, andaj edhe ipeshkvi nuk kish ç'të kërkonte më aty: „... *benche forzi anticamente s'estendesse ne piani, ora essendo abitati da Turchi. Il Vescovo non ha che operare in detti piani.*“<sup>3</sup>

Dioqeza shtrihej në verilindje të Shqipërisë së sotme, duke u kufizuar në veri dhe perëndim me Dioqezën e Shkodrës e në jug me Dioqezën e Sappës; në lindje ishte bash lumi i Valbonës që sendërtonte kufirin natyror me Serbinë, d.m.th. me Arqipeshkëvinë e Shkupit.<sup>4</sup> Hapësira e dioqezës ngërthehte në gjatësi dhe gjerësi një ditë të tërë mushke sipas Zmajević-it, dhe plot dy ditë sipas relacionit të vizitës baritore të ipeshkvit Marco Negri më 1799.<sup>5</sup> Në gjithë dioqezën nuk kish asnjë qendër urbane, përveç fshatrave, ndër të cilët vetëm ndonjë syresh numëronte aty te 1500 banorë, të tjerët njehnin rreth 1000 banorë ose më pak. Vetë numri i fshatrave shënohej zakonisht diku më shumë se dyzet, ndërsa ai i banorëve vlerësohej rrokull 20.000 frymë,

2 Peter Bartl (Hrsg.), Quellen und Materialien zur albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert. II. München 1979. f. 50-57.

3 Notizie circa la Diocesi, e Vescovato di Pulati in Albania = Archivio Storico della S. C. di Propaganda Fide (fortan APF), SC Albania 9, fol. 324.

4 Concilium Provinciale sive Nationale Albanum. Habitu Anno MDCCIII. Rom 1706. Nachdruck besorgt von Mons. Zef Gashi: Kuvendi i Arbënit. Tirana. Prishtina 2003. f. 84-85.

5 APF, SC Albania 21, fol. 47.

duke përfshirë këtu sigurisht edhe të pafetë, d.m.th. myslimanët. Në fshatrat famullitare të gjithë banorët ishin katolikë, përjashto ndonjë besëshkalë që kishte përqafuar dikur – larg vendlindjes – fenë islame, por që pas rikthimit në vatrën e të parëve i ishte drejtuar sërishmi besimit të hershëm.<sup>6</sup>

Sundimi osman ndihej pak në dioqezë. Arqipeshkvi Zmajević tëharrte në mendimin se ishin bash malet, përkatësisht papërshekueshmëria e gjithë krahinës ato çka i kishin shpëtuar banorët e saj ndaj nënshtrimit turk.<sup>7</sup> Në një përmbledhje (*Sommario*) të Propaganda Fide-s që datohet në vitin 1745 thuhet se turqit nuk qullasnin dot të kryenin patrullime në dioqezë e t'u merrnin tribut të krishterëve. Madje vetë ipeshkvi – përkundër gjegjëseve të vet në dioqezat e tjera shqiptare – nuk shlyente asnjë lloj detyrimi ndaj turqve.<sup>8</sup> Pavarësisht këtyre mëtimeve, e gjithë dioqeza në tërësinë e saj ishte rrokur ndërkohë në strukturat e aparatit administrativ osman, duke iu nënshtruar zyrtarisht hyqmit të Pashait të Pejës ose të Gjakovës: "*Questi Popoli di Puliti nel temporale sono sudditi dell'Imperatore di Costantinopoli, e governati da suoi Ministri pro tempore, cioè ora dal Bassà di Pecchia, ed ora da quello di Giacova, che sono due Citta distanti dai confini di Puliti una buona giornata.*"<sup>9</sup> Gjithsesi asnjë përfaqësues i pushtetit shtetëror nuk kishte rezidencën e vet në hapësirën e dioqezës.<sup>10</sup> Në rastet e plaçkitjeve masive ose të kryengritjeve shteti detyrohej të ndërhynte kryesisht me dërgimin e ekspeditave ndëshkuese. Kështu p. sh. Shoshi u dogj dy herë, në vitet 1732 dhe 1761, prej trupave të pashait të Pejës<sup>11</sup>, ndërsa në vitin 1785 ishte popullsia e Nikajt ajo që u detyrua të braktiste vendin për shkak të rebelimeve të ndëshkueshme: "*essendosi ribellata la Parrochia di Nichagni al Commandante Turco, furono l'anno scorso dal detto scacciati.*"<sup>12</sup> Pasojë e një lëvizjeje kryengritëse mund të ishte edhe ndërrimi me forcë i besimit. Kështu ndodhi p. sh. me banorët e <Bunjaj>-t dhe të Kolgecajt, të cilët Ota Pascha (Choda Verdi Pascha Mahmutbegović i Shkodrës – 1705 ?) i detyroi të puthin kuranin.<sup>13</sup>

Në relacionet e vizitave baritore, si në ato të ipeshkvijve ashtu

6 Notizie circa la Diocesi = APF, SC Albania 9, fol. 324-324v.

7 Bartl, Quellen und Materialien II. f. 51.

8 APF, SOCG 725, fol. 119-119v.

9 Bericht des Präfekten der Franziskanermission in Pulati Fr. Luigi Maria di Roma an die Propaganda Fide, 20. Februar 1769 = APF, SC Albania 12, fol. 552.

10 Ebenda, fol. 558.

11 Ebenda, fol. 555.

12 Schreiben der Franziskanermissionare in Pulati an die Propaganda Fide, 2. August 1786 = APF, SC Albania 18, fol. 222v.

13 Visitationsbericht Fr. Ruffino di Castelnovo, ca. 1743/44 = APF, SC Albania 9, fol. 216v.

edhe në ato të prefektëve të misionit françeskan, banorët e Dioqezës së Pultit nuk feksin aspak me ngjyrë rozë. Zmajević-i i dallon në fakt si liridashës, por ata e çonin jetën me plaçkitje dhe hajni, e në këto veprime nuk bënin përjashtim as pronësitë e kishës. Ata jetonin sipas së drejtës së vet zakonore dhe nuk u lejonin të huajve të hynin në territorin e tyre. Me mosbesim silleshin edhe ndaj klerit, i cili në shumicën e rasteve ishte po ashtu i huaj. Ata trupëzonin në vetvete dy cilësi ekstreme: varfërinë e madhe dhe ambicien tejet të lartë ndaj vetvetes. Pjesën më të madhe të vitit e çonin gjysmëlakuriq, dhe për shkak të shterpësisë së zonës u mungonin vetë kushtet më të domosdoshme të jetesës. Megjithatë ata vlerësonin lart vetveten (: *hanno di se stessi concetto così grande*), duke parapëlqyer vdekjen kundrejt nënshtrimit.<sup>14</sup>

Frat Luigi Maria di Roma, prefekt i misionit françeskan shkruante në raportin e tij të vitit 1769 se në Pult sundonte ligji i më të fortit. Armiqësitë gëlonin jo vetëm ndërmjet katundeve, por edhe brenda një katundi (: *chi è più forte danneggia, ammazza, incendia case, fieni, e fa mille iniquità*). Vjedhja e rrëmbimi i bagëtisë ishte në rend të ditës. Barinj, udhëtarë, madje edhe vetë misionarë vriteshin, në rast se gjendeshin jashtë famullive të tyre.<sup>15</sup> Emër famëzi gëzonte atëbotë ndër vizitorët pastoralë sidomos Shoshi, të cilin prefekti Ruffino di Castelnuovo e përnëm si vendin më të keq në gjithë Pultin, ku shumica e banorëve qenkëshin kusarë e hajna: *Questa Villa di Scioscj è la più cattiva, che si possa dare perche oltre li proferti privi di Legge [të cilët ishin përjashtuar prej sakramenteve për shkak të shkeljeve të ndryshme ndaj të drejtës kishtare], la maggior parte sono ladri, et assassini, e non fa perdono nè a Turchi, nè a Cristiani*. Misionarët françeskanë e paskëshin braktisur atë vend, meqë paskëshin qenë sulmuar dhe plaçkitur prej banorëve të tij.<sup>16</sup>

Dioqeza e Pultit përmendet së pari në vitin 877 dhe në periudhën midis viteve 1340 – 1520 ishte ndarë më dysh: Pulti i Epër (*Pulati maior*) dhe Pulti i Poshtër (*Pulati minor*). Pas pushtimit osman dioqeza zuri të funksionojë rregullisht prej vitit 1656. Përgjatë shek. të 18-të aty gjëllitën nëntë ipeshkvij: Pjetër Karaxhiq, (Petrus Caragich – 1698-1702), Marin Gjini (Marinus Gini – 1703-1719), Pjetër Skurra (Petrus Scura – 1719-1720), mark Deluki (Marcus Deluchi<sup>17</sup> – 1731-1746), Seraphinus Torriani OFM Ref. (1746-1756), Gjergj Xhunki (Georgius Giunchi – 1757-1765),

<sup>14</sup> Bartl, Quellen und Materialien II. S. 51.

<sup>15</sup> APF, SC Albania 12, fol. 558-558v.

<sup>16</sup> APF, SC Albania 9, fol. 216v.

<sup>17</sup> Në listat e ipeshkvijve të Eubel-it dhe Gams de Luchi-it; ai vetë përdorte në fakt variantin Deluchi të emrit, khs. mesazhin e tij të datës 10 tetor 1743 për Propaganda Fide-n, ku ai shënon emrin Marco Deluchi = APF, SOCG 721, fol. 168-273.

Llesh Bardhi (Alexander Bianchi – 1766-1780), Gjon Logoreci (Joannes Logorezzi – 1781-1791) dhe Marcus Negri (1791-1808). Me përjashtim të Torriani-t të gjithë ishin etër shekullarë me origjinë shqiptare.

Dioqeza e Pultit përbënte një përjashtim në gjithë provincën e Arbënisë, meqë ipeshkvi kishte nën juridiksion vetëm dy priftërinj shekullarë dhe në vendin ku kishte selinë e vet (në shek. e 18-të ishte Xhani – *Giovagni, Gioagni, Gioani*), ushtronte edhe funksionin e famullitarit. Të gjitha famullitë e tjera – meqë në dioqezë mungonte shkollimi fetar – mbuloheshin me misionarë të huaj, të cilët i përkisnin degës së reformuar të Urdhrit Françeskan. Këta ishin thuajse të gjithë italianë për nga nacionaliteti. Kështu p. sh. në vitin 1764 vepronin në misionin françeskan të Pultit: At Luigi Maria da Roma, At Gabriele da Montoro, At Bernardino da Zangarone, At Teodosio da Rughansa, At Articinio da Sanno, At Casimiro da Quatordio, At Angelo d'Acuto, At Pietro d'Ortonovo, At Francesco da Roveredo, gjithashtu edhe katër misionarë të tjerë që nuk përmenden me emër, si edhe Fr. Tadeo d'Albano Bergamasco si prefekt.<sup>18</sup> Herë pas here shfaqen edhe emra që nuk i takojnë hapësirës gjuhësore italishtfolëse, si p.sh. At Teodosio Bezer prej provincës françeskane të Köln-it, i cili drejtonte në vitin 1769 ospicën e misionit në Kir<sup>19</sup> ose në vitin 1785 At Eduardo da Praga, që vepronte në Shosh.<sup>20</sup> Zmajević-i kumton më 1703 për në Toplanë lidhur me një at gjerman me emrin Hilarione, i cili ishte në fakt shumë i zellshëm, por krejt i paaftë për të përvetësuar shqipen në mënyrë të rrjedhshme, e kjo për shkak të theksit të tij gjerman: "*inabile ad apprendere con perfettione la lingua paesana à causa della pronunzia tedesca tanto contraria all' Albanese.*"<sup>21</sup>

Prej misionarëve pritej që jo vetëm të zotëronin gjuhën shqipe. Ata duhej gjithashtu të gëzonin shëndet të plotë, të ishin të fuqishëm dhe aktivë, përndryshe vështirë se do të mund të përballonin detyrimet e tyre në një zonë të tillë, të ashpër malore siç ishte Pulti. Krahas ospicës ata kishin për të ndjekur shërbesat e tyre në shumë fshatra që shpesh shtriheshin larg njëri-tjetrit. Për më tepër ata duhej të përkujdeseshin vetë për riparimin dhe mirëmbajtjen e kishave dhe banesave të tyre.<sup>22</sup> Kështu p. sh. më 1768 ishte At Michelangelo d'Acuto ai që rindërtoi vetë e pa kurrfarë ndihme kishën dhe ospicën në Rajë: "*con la sua*

18 *Relatione della Missione di Pulati del 1764* = APF, SC Albania 11, fol. 599 v.

19 *Relazione delle Stato presente delle Missioni di Puliti 1769* = APF, SC Albania 12, fol. 555 v.

20 Fr. Casimiro da Quattordio, Prefekt i Misionit Fra006Eeskan të Pultit, drejtuar Propaganda Fide-s, 2. gusht 1786 = APF, SC Albania 18, fol. 222.

21 Bartl, *Quellen und Materialien II.* f. 56.

22 *Intiera Relatione della Missione di Pulati dei 1765* = APF, SC Albania 12, fol. 166v.

*industria senza un minima aiuto di alcuno*".<sup>23</sup>

Në vitin 1703, kur arqipeshkvi Zmajević vizitoi Dioqezën e Pultit, në të gjendeshin tri Famulli ose ospica, në të cilat shërbenin pesë misionarë françeskanë. Në fund të shek. të 18-të kishte 9 ospica, ndërsa numri i etërve shpirtërorë lëkundej ndërmjet 8 (1786) dhe 12 (1765), duke përfshirë këtu edhe prefektin.

Ospicat në radhën alfabetike,  
me të dhëna mbi numrin e banorëve të besimit katolik<sup>24</sup>

Dushmani (*Duscmani, Dusmani, Dosmani*)

1764: 100 shtëpi, 1200 frymë

1765: 137 shtëpi, 1120 frymë

1769: 145 shtëpi, 1230 frymë

1786: 145 shtëpi, 1129 frymë

1791: 135 shtëpi, 902 frymë

1792: 132 shtëpi, 900 frymë

1799: 146 shtëpi, 1005 frymë

Kiri

1764: 76 shtëpi, 473 frymë

1765: 76 shtëpi, 461 frymë

1769: 70 shtëpi, 423 frymë

1786: 71 shtëpi, 461 frymë

1791: 75 shtëpi, 500 frymë

1792: 75 shtëpi, 511 frymë

1799: 82 shtëpi, 523 frymë

Merturi (*Marturi*)

1764: 108 shtëpi, 980 frymë

1765: 110 shtëpi, 1200 frymë

Nikaj (*Nicagni*)

1786: 68 shtëpi, 494 frymë

1791: 103 shtëpi, 870 frymë

1792: 109 shtëpi, 943 frymë

1799: 115 shtëpi, 1003 frymë

Palçi (*Palci*)

1765: 174 shtëpi, 1500 frymë (me Nikajn)

1792: 29 shtëpi, 250 frymë

---

<sup>23</sup> Relacion i vizitës baritore të Prefektit Fr. Luigi Maria di Roma, 20. shkurt 1768 = APF, SC Albania 12, fol. 552v.

<sup>24</sup> Hartuar sipas relacioneve të vizitave baritore të ipeshkvijve ose të prefektëve të Misionit Françeskan në pult. Të dhënat me shifra kanë të bëjnë më të shumtën e rasteve me katundet, që mbuloheshin nga ospiciet.

Plani (*Plandi, Planti*)

1703: 112 shtëpi, 926 frymë  
1743/44: 165 shtëpi, 1133 frymë  
1764: 184 shtëpi, 1240 frymë  
1765: 149 shtëpi, 954 frymë  
1769: 152 shtëpi, 1019 frymë  
1786: 152 shtëpi, 987 frymë  
1791: 154 shtëpi, 956 frymë  
1792: 169 shtëpi, 990 frymë  
1799: 140 shtëpi, 1015 frymë

Raja (*Aragna, Arugna, Ragna*)

1769: 116 shtëpi, 1239 frymë  
1786: 60 shtëpi, 512 frymë  
1791: 64 shtëpi, 592 frymë  
1792: 68 shtëpi, 688 frymë  
1799: 66 shtëpi, 600 frymë

Selca (*Salza*)

1769: 213 shtëpi, 1212 frymë  
1786: 67 shtëpi, 445 frymë  
1799: 78 shtëpi, 620 frymë

Shala (*Scialla*)

1743/44; 92 shtëpi, 982 frymë  
1764: 180 shtëpi, 1565 frymë  
1765: 180 shtëpi, 1546 frymë  
1769: 184 shtëpi, 1729 frymë  
1784: 205 shtëpi, 1242 frymë  
1791: 219 shtëpi, 1627 frymë  
1792: 215 shtëpi, 1588 frymë  
1799: 222 shtëpi, 1610 frymë

Shoshi (*Sciosci*)

1703: 156 shtëpi, 1367 frymë  
1743/44: 108 shtëpi, 630 frymë  
1764: 140 shtëpi, 1200 frymë  
1765: 138 shtëpi, 835 frymë  
1769: 138 shtëpi, 1013 frymë  
1786: 137 shtëpi, 898 frymë  
1791: 127 shtëpi, 958 frymë  
1792: 127 shtëpi, 962 frymë  
1799: 135 Häuser, 1200 frymë

Toplana

1703: 295 shtëpi, 2303 frymë (me  
14 katunde të tjerë)

1743/44: 166 shtëpi, 1481 frymë  
1764: 45 shtëpi, 415 frymë  
1765: 48 shtëpi, 342 frymë  
1769: 54 shtëpi, 405 frymë  
1786: 90 shtëpi, 435 frymë  
1791: 47 shtëpi, 384 frymë  
1792: 43 shtëpi, 309 frymë  
1799: 42 shtëpi, 302 frymë

Në relacionet e prefektëve të misionit Françeskan nuk jepet asnjë e dhënë mbi vendndodhjen e ipeshkvit, sepse ata nuk ishin të lejuar për ta vizituar atë.

Xhani (*Giovagni, Gioagni*)

1703: 33 shtëpi, 387 frymë  
1743: 65 shtëpi, 344 frymë  
1743/44: 53 shtëpi, 356 frymë<sup>25</sup>  
1744/45: ca. 50 shtëpi<sup>26</sup>  
1799: 99 shtëpi, 703 frymë

Numri i përgjithshëm i katolikëve në dioqezën e Pultit (i përmendur nga relatorët ose i llogaritur nga të dhënat prej ospicave të veçanta).

1703: 653 shtëpi, 4546 frymë<sup>27</sup>  
1743: 827 shtëpi, 6322 frymë<sup>28</sup>  
1743/44: 806 shtëpi, 8556 frymë  
1764: 956 shtëpi, 7813 frymë  
1765: 1008 shtëpi, 7858 frymë  
1769: 1072 shtëpi, 8260 frymë  
1786: 995 shtëpi, 6663 frymë  
1791: 953 shtëpi, 7262 frymë  
1792: 970 shtëpi, 7131 frymë  
1799: 1134 shtëpi, 8581 frymë<sup>29</sup>

Parë nga numri i besimtarëve, Pulti përfaqëson dioqezën më të vogël të provincës së Arbënisë në shek. e 18-të. Në relacione jepen shumë rrallë të dhëna mbi besimtarët myslimanë, meqë vizitorët pastoralë shkonin rregullisht vetëm në zonat e banuara kryesisht nga të krishterët. Në katundet e krishtera jetonin sipas Zmajević-it (1703

<sup>25</sup> Përmendja në relacion e prefektit Fr. Ruffino di Castelnuovo përbën një përjashtim.

<sup>26</sup> Notizie circa la Diocesi, e Vescovato di Pulati in Albania = APF, SC Albania 9, fol. 324.

<sup>27</sup> Vinzenz Zmajević, Nota distinta delle Parochie, Ville, case, et anime cattoliche, scismatiche, e turchi in cadauna Diocesi d'Albania, në: Bartl, Quellen und Materialien II. f. 152.

<sup>28</sup> APF, SOCG 721, fol. 273.

<sup>29</sup> APF, SC Albania 21, fol. 48v.

49) familje myslimane me deri 642 Persona.<sup>30</sup> Përndryshe prania e myslimanëve përmendet sipas kohës dhe rastit. Kështu p.sh., sipas ipeshkvit Marco Deluchi, që vizitoi atë katund më 1743, gjëllinin në Sumë atëbotë pranë 17 familjeve katolike edhe 24 myslimane. Në katundet Bunjaj, Kolgecaj dhe Shoshani që shtriheshin përgjatë brigjeve të Valbonës, e që ndërkohë ishin islamizuar, kishte ende ndoca të krishterë të fshehtë si edhe shumë gra që i kishin mbetur besnike besimit të parë. Gjithsesi banorët e atyshëm nuk e lejonin ipeshkvin të kryente vizitën baritore, meqë druheshin, se mos turqit pastaj do t'u rrisnin tributin.<sup>31</sup> Marrëdhëniet ndërmjet malësorëve katolikë dhe myslimanë zhvilloheshin në fakt pa probleme. Edhe martesat e përziera ishin bukur të shpeshta, sikurse pohon edhe prefekti Fr. Luigi Maria di Roma për banorët e Rajës më 1769. Ata jetonin: "... un poco libertino, praticando ogni giorno con Maomettani e con Rinegati, come anche dando alcuni in Marito le Figlie al Turco, con tutto ciò nella Fede sano costanti."<sup>32</sup>

\* \* \*

Së fundi edhe dy fjalë për ngjarjen në Shosh, që është edhe objekti i letrës së françeskanëve të Pultit. Për këtë ngjarje raporton edhe prefekti i Misionit Françeskan të Pultit 1769, por ndryshe nga sa përshkruhet në letër. Sipas tij është fjala për një ekspeditë ndëshkuese kundër banorëve të Shoshit, të mirënjohur si kusarë e që për më tepër si të krishterë nuk pranonin të paguanin taksën e xhezasë. Për këtë arsye pashai i Pejës urdhëroi të digjej Shoshi, siç kish bërë ndërkohë edhe në vitin 1732, khs.: „*Questa Villa [Shoshi] per esser la maggior parte gente selvatica, belligera, Assassini di strada, e ribelli quasi sempre al Turco, perche non vogliono darli il tributo, l'anno 1761, come anche nel 1732 fu abbrugiata dal Bassà di Pecchia: Non essendovi ora nè Chiesa, nè Casa, ma solo una piccola Capanna per abitazione del Missionario, quale con un poco di limosina doppo abbrugiamento a tal'effetto radunata fra li Missionarj, avrebbe rifabbricato almeno l'Ospizio, se avesse voluto, e volesse la Villa ajutarlo, non vedendosi però finora alcuna disposizione.*”<sup>33</sup>

## 2.2. Letra e fretërve të Pultit dhe disa çështje që lidhen me të

Ekspeditën ndaj zonës së Shoshit (dhe të Kirit) e ndërmori vetë Karaman Pasha me seli në Pejë aty nga fundi i muajit janar dhe fillimi i muajit shkurt të vitit 1761. Masat ndëshkuese nuk shmangën këtë radhë as objektet e kultit, madje as vetë fretërit misionarë, të cilët jesnin atëbotë në ospicën e tyre në Shosh, nën besën e Ahmet Agës – adjutantit

30 Zmajević, Nota distinta, në: Bartl, Quellen und Materialien II. f.152.

31 Ipeshkëv Marco Deluchi, dërguar Propaganda Fide-s më 10. tetor 1743 = APF, SOCG 721, fol. 268v.


32 APF, SC Albania 12, fol. 553-553v.

33 APF, SC Albania 12, fol. 554 v.-555.

që drejtonte hordhinë e Karaman Pashës. Ishte pikërisht ky person që i mori ata nën arrest, duke u kumtuar njëherësh edhe dënimin kapital, dënim i cili nuk u ekzekutua falë ndërhyrjeve të kreut të fisit të Shalës si edhe kundrejt një harxhi aspak të vogël në të holla. Këtë ndodhi e përcjellim në punimin e fundit të Sarro-s<sup>34</sup>, ku autori ynë përshkruan në detaj, ndër të tjera, edhe fatin e pafat të xhakoit 9-vjeçar Gjergj Jak Tuzi, për lirimin e të cilit popullsia katolike shqiptare nuk mungoi të mbledhë vullnetarisht e të depozitojë shumën atëbotë marramendëse prej më se 300 realësh që ishte vënë kusht, meqë ky cullak kryefortë nuk pranonte assesi konvertimin e tij në fenë islame.

Letra në fjalë merr shkas pikërisht nga ky episod rrënoqthës: fretërit françeskanë nuk mjaftohen të ankohen me shkrim thjesht dhe vetëm për djegien dhe dhunimin e objekteve të kultit në Shosh, si edhe për besën e pabesë që u dhuroi atyre Ahmet Aga. Ata tëharrin fort që të lirohet voci i panjollë, i cili vuante në burg thjesht dhe vetëm për bindjet e tij fetare.

Leximi i kujdesshëm i vetë letrës i hap shteg debatit për çështje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt ose tërthorazi me të ashtuquajturat paratekste të tekstit në fjalë, e ndër të tjera: a) data e hartimit të letrës; b) instanca e lartë apo personaliteti, të cilit i drejtohej vetë letra; c) arsyet e shkrimit të saj shqip (dhe italisht); dhe së fundi d) përkatësia gjuhësore-etnike e hartuesit të letrës.



## 2.1. Viti i hartimit të letrës: 1762 apo 1761?

Sa i përket datës së hartimit të letrës, lë vend për diskutim vetëm viti i hartimit të saj, për të cilin mëtohet viti 1762<sup>35</sup>. Shkruesit e këtyre radhëve janë gjithsesi të mendimit se koha e hartimit të letrës do tërhequr një vit më parë, d.m.th. që kjo letër të jetë shkruar bash më 13 shkurt të vitit 1761, d.m.th. menjëherë pas lirimimit të fretërve misionarë<sup>36</sup>, ndërkohë që kushtet e burgimit vazhdonte t'i vuante i vetëm djaloshi 9-vjeçar.

Këtë përsiatje e mbështet, krahas rrjedhës reale të ngjarjeve<sup>37</sup>, përkatësisht të rrethanave që pasqyrohen në letër, edhe një argument i karakterit grafologjik. Gjatë konsultimeve paraprake, shkruesit e këtyre radhëve kanë ardhur në përfundimin e përbashkët se njësia e fundit e shifrës vjetore nuk përfaqëson aspak një numër por një shkronjë (= <176i>), pikërisht shkronjën <i>, e cila përdorej rëndom në korrespondencën e kohës me vlerën e shifrës <1>.

## 2.2. Personi, të cilit i drejtohet letra

Edhe pse nuk kemi informacion të drejtpërdrejtë lidhur me personin apo instancën e lartë administrative, së cilës i drejtohet kjo letër, përshkrimi i hollësishëm i djegies e shkatërrimit të Shoshit, së bashku me masat represive që ndërmorën hordhitë turke, e përforcojnë mendimin se kjo letër i drejtohet pikërisht Karaman Pashës me seli në Pejë, d.m.th. pashait që mëtonte të kishte nën juridiksionin e njësisë së tij administrative-ushtarake edhe zonën e Dukagjinit<sup>38</sup>.

## 2.3. Përse është shkruar letra shqip (dhe italisht)

Ndryshimi i destinacionit të letrës drejt lindjes, pra drejt zonës qendrore të Ballkanit lejon tash të sugjerojmë në formë diskutimi edhe arsyen e përdorimit të shqipes së shkruar – krahas italishtes – si mjet komunikimi zyrtar. Pas gjase kemi të bëjmë këtu me mëdyshjet e shkruesit të letrës – mosnjohës i turqishtes / osmanishtes? – se mos Karaman Pasha i Pejës, përkatësisht personeli i tij shërbyes, nuk e zotëronin italishten, një gjuhë që funksiononte atëbotë kryesisht si mjet komunikimi ndërmjet klerit katolik në Shqipëri dhe Kurisë së Shenjtë. Këtë mendim e tumir nga një tjetër këndvështrim edhe letra e parë shqip që njohim deri sot, datuar më 30 maj 1689, e cila ndoshta jo rastësisht është përsiatuar dhe diktuar si e tillë pikërisht në një katund të anëve lindore të dioqezës së Pultit<sup>39</sup>.

## 2.4. Shkruesi i letrës

Nënshkrimi <Fratinit e Pulitit> që përmbyll letrën është ndoshta një

35 Sarro: HD 2 [2007] 163v; HD 2 [2008] 81v.

36 Në fillim të muajit shkurt të vitit 1761, khs. Sarro: HD 2 2008 76vv

37 Sarro: *loc. cit.*

38 Shih lart shën. 35.

39 Shih P. Bartl – M. Camaj: Ein Brief in albanischer Sprache aus Gashi vom Jahre 1689, në: *Zeitschrift für Balkanologie*, (5) [1967] 22-33.

tregues më se i mjaftueshëm, për të ardhur në përfundimin se hartuesi i saj në rastin më të mirë zotëronte shqipen e folur dhe të shkruar, por nuk ishte një native speaker. E kjo për një arsye më se të thjeshtë: misioni françeskan në Dioqezën e Pultit mbulohej atëbotë vetëm me misionarë të huaj<sup>40</sup>. Këtë tregues e tumir gjithashtu katërcipërisht analiza grafike e ndonjë fjale apo fjalëforme që pasqyron difekte, përkatësisht shqiptime të pazakonshme të shqipes së folur në arealin dialektor të Veriut gjatë kësaj periudhe, khs.: <ichini> = /íkini/ apo <tretini> = /trétini/ me zanore mbështetëse në rrokjen e dytë (në vend të \*<ichni> = /ikni/, \*<tretni> = /trétni/). Kemi gjithashtu në tekst dy grafi me mbylltoren <-d-> = /d/ në trup të fjalës, khs.: <te maden> = /të máden/ dhe <e barde> = /e bárdë/ (në vend të formave të pritshme me gjegjësen frikative <ξ> = /dh/, khs.: \*<te maçen> = /të madhen/; \*<e barçe> = /e bárdhë/) etj. Një tjetër tregues që e tumir këtë mendim është mosdallimi grafik i tingujve qiellzorë /q/, /gj/ (= [ç], [j])<sup>41</sup>, që janë të huaj për sistemin fonetik të italishtes a të një gjuhe tjetër perëndimore, duke u shqiptuar dhe pasqyruar kështu grafikisht njëloj si bashkëtingëlloret afrikate /ç/, /xh/ (= [tʃ], [dʒ]), khs. <cisc> = /çish/, <dogie> = /doxhe/ në vend të \*/qish/, \*/dogje/ etj. (sh. më poshtë § 3.2.).

### 3. Teksti shqip dhe sistemi grafik që përcillet në të

Përshkrimi i sfondit historik e social-kulturor dhe zberthimi i përmbajtjes së letrës si edhe shestimi i përsiatjeve të reja, që kanë të bëjnë me datimin dhe adresimin e saj, apo me arsyet e hartimit të (një pjesë të) tekstit shqip, mbulojnë vetëm një pjesë të qëllimit të studimit tonë. Ribotimi filologjik i tekstit, të cilit do t'i përkushtohemi në këtë rubrikë, përbën një tjetër hallkë të këtij qëllimi. Përmbushja e tij parakupton, ndër të tjera, parashtrimin dhe zgjidhjen e disa çështjeve që kanë të bëjnë me zberthimin e kodit alfabetik dhe njohjen e rregullave grafike e ortografike, të zbatuara në tekst. Paraqitja paraprake dhe rezultative e hulumtimit të këtyre çështjeve shpresojmë që të lehtësojë leximin dhe njohjen e tij, të cilin lexuesi mund ta përcjellë më poshtë paralelisht në dy kollona: në versionin e transliteruar (A = riprodhimi diplomatik) dhe në atë të transkriptuar (B = transkriptimi i zgjeruar), të cilët pasohen nga komentaret përkatës për çështje të ndryshme të karakterit grafik, gjuhësor dhe semantik. Gjithsesi për çdo gjetje dhe interpretim lexuesi mund të marrë pjesë aktive në diskutim, duke bërë përqasjet e rastit me faksimilen e botuar më sipër.

40 Sh. me lart § 2.1; sh. edhe I. Sarro: HD 2 2008 74vv.

41 Në këtë zonë këto mbylltore janë shndërruar në afrikate mesgjuhore [tç], [dž]; sh. J. Gjinari: Dialektet e gjuhës shqipe, Tiranë 1989 156v.

Eccss.mo Sig.re

Tutti i Frati di Puliti baciano la terra, li piedi, e le mani di Vostra Ecc.<sup>za</sup>. Con la presente le notificano come essendo giunto in Marturi Amet Aga tuo Ceaja li andiede avanti il Frate di Marturi, e lo pregò a nome di tutti i Religiosi se Vostra Ecc.<sup>za</sup> aveva cosa contro di essi frati, che sono nelle Chiese di Puliti; Li rispose il Ceaja che Vostra Ecc.<sup>za</sup> non l'aveva mandato ne per i Frati, ne per guastare le Chiese, e li diede la Bessa, e la fede dicendoli, Mos ichini, mos trettini gaa, mos sdroni, se vne iam per iuu, e curcusc s ka me guzem me v ngaam.

Appena giunto in Sciosci il Ceaja ordinò a Ciudarbasci che saccheggiasse e abbruciasse la Chiesa, perche alcuni Maligni li avevano detto che la Chiesa di Sciosci era una Fortezza, e che i sciosciniani si erano forzati in quella, il che è stato falso, non avendoli lasciati i Religiosi, anzi si affaticarono di farli venire all'obbedienza di V. Ecc.<sup>za</sup> con li pegni f. [fatti?] mà li detti non volsero ubbidire, e fuggirono.

Ora, Eccss.<sup>mo</sup> Sig.<sup>re</sup> tu sai che noi frati qui siamo col Fermano dell' Imperatore di Costantinopoli, e siamo stati, siamo e saremo sudditi de suoi Bassa che sono governatori pro tempore di Puliti: Pasc Tenzone, Pasc feen e Maumetit, Per Kr8et tat, Per Scendet te Bekchleuere ci kie, Pasc Dovletin ci te ka ʒan ʔot8n, e Mpereti, e ta ritt ʔot8n Ogiakun nd dacc me sperbleem nde kete jeta, e mbat jeta at Giuna te maden ci bane se na prove, na dogie, e na bane pluhen paa fai, e per ndeer Tineʔot lesciona at Dialin ci na

Eccss.mo Sig.re

Tutti i Frati di Puliti baciano la terra, li piedi, e le mani di Vostra Ecc.<sup>za</sup>. Con la presente le notificano come essendo giunto in Marturi Amet Aga tuo Ceaja li andiede avanti il Frate di Marturi, e lo pregò a nome di tutti i Religiosi se Vostra Ecc.<sup>za</sup> aveva cosa contro di essi frati, che sono nelle Chiese di Puliti; Li rispose il Ceaja che Vostra Ecc.<sup>za</sup> non l'aveva mandato ne per i Frati, ne per guastare le Chiese, e li diede la Bessa, e la fede dicendoli: Mos ikini, mos tretini xhā, mos sdroni, se une iam per iū, e kurkush s'ka me guxuem me u ngām.

Appena giunto in Sciosci il Ceaja ordinò a Ciudarbasci che saccheggiasse e abbruciasse la Chiesa, perche alcuni Maligni li avevano detto che la Chiesa di Sciosci era una Fortezza, e che i sciosciniani si erano forzati in quella, il che è stato falso, non avendoli lasciati i Religiosi, anzi si affaticarono di farli venire all'obbedienza di V. Ecc.<sup>za</sup> con li pegni f. [fatti?] mà li detti non volsero ubbidire, e fuggirono.

Ora, Eccss.<sup>mo</sup> Sig.<sup>re</sup> tu sai che noi frati qui siamo col Fermano dell' Imperatore di Costantinopoli, e siamo stati, siamo e saremo sudditi de suoi Bassa che sono governatori pro tempore di Puliti: Pash Tenzone; pash fēn e Maumetit; per kryet tat; per shendet tē beklevere ʒi kie; pash Dovletin ʒi te ka dhan Zotyn e Mpereti, e ta rit Zotyn oxhakun nd' daç me shperblēm nde kete jeta, e mbat jeta at xhuna te maden ʒi bane se na prove, na doxhe, e na bane pluhen pā fai, e per ndēr Tinezot leshona at dialin ʒi na

more rob; Nde mos ke me paam se nuk skon scium mott cisc ka me punuem εot8n me t88, e me Ogiakun tande.

Per Laft Tineεot, per te miir tande ndighiò keto fial, e mos mer fial te Monaficheue e t'at8ne ci po scitjne kecc. Nde ke ment me lesciuem Dialin ebia ndora Meemetit i Marturit te na bien ketu, se na kemi me lutun Tineεot per t88, e per ogiakun tande me te lijruem, e me te fal nde kete jeta, e mbat jeta kete Giuna te maden ci na bane me bessen e me fee tande.

Pacc facien e barde perpara Mperetit, e perpara kessai Jets, e Jemi, e Jessem giççere te tuu scerbetoret. Fratinit e Pulitit  
Li 13 febbrajo 1761 =

### 3.1. *Tipare të grafisë së tekstit*

Një vështrim sado i përciptë i tekstit shqip të krijon menjëherë bindjen se në të është zbatuar i ashtuquajhuri “Alfabet i Propagandës”, më se i njohur në botimet shqip në arealin ose me destinacion arealin kulturor të Shqipërisë së Veriut (katolik)<sup>43</sup>. Për këtë po mjaftohemi të kumtojmë përmbledhtas, që:

- a) Alfabeti i përdorur në këto shkrime bazohet fund e krye në atë të latinishtes (mesjetare dhe të italishtes), khs.: <a b c d e f g h i j k l m n o p r s t u/v z>. Sikurse edhe në botimet shqip të arealit kulturor-fetar të Veriut, përdoren në tekst edhe tri karaktere grafike po aq tradicionale, por me tjetër burim: <8 ξ ε>.

42 Përshtatje e tekstit shqip në shqipen standarde: [Mos ikni, mos tretni gjë, mos druani, se unë jam me ju, e kurrkush s'ka me guxuar me u ngarë. / Pafsh Tënëzonë!; pafsh fenë e Muhametit!; për kryet tat!; për shëndet të Beklerëve që ke!; pafsh Dovletin që të ka dhënë Zotyn e Mbreti!, e ta rittë Zotyn oxhakun!. Në daç me (e) shperblyer në këtë jetë, e në atë jetë atë gjynah të madh që na bëre se na prove, na dogje, e na bëre pluhur pa faj, e për nder (të) Tinëzot, lëshona atë djalin që na more rob; nëmos ke me parë se nuk shkon shumë mot, qysh ka me punuar Zotyn me ty, e me oxhakun tënd. / Per lavd Tinëzot, për të mirë tënde dëgjo këto fjalë, e mos merr fjalë të monafikeve e të atyre që po shtijnë keq. Në ke [ndër] mend me leshuar dialin jepia në dorë Mehmetit të Mërturit të na e bierë këtu, se ne kemi me lutur Tinëzot për ty, e për oxhakun tënd me të liru e me të falë në këtë jetë e në atë jetë këtë gjynah të madh që na bëre me besën e me fenë tënd. / Paç façen e bardhë përpara Mbretit e përpara kessai jete, e jemi e jesim gjithërë shërbëtorët e tu. / Fretërit e Pulitit].

43 Për një traditë të ngjashme të shkrimit shqip në zonën e Himarës shih së fundi B. Demiraj: Zef Skiroi në kulturën e shkrimit shqip të shek. XVIII, në: *Studime* 12 [2005] 67-97.

- b) Mjetet grafike të përdorura në kod përkojnë plotësisht me ato të arealit kulturor të Veriut, i cili bazohet kryekëput në rregullat (orto)grafike të shkrimit të italishtes. Dallojmë këtu, ndër të tjera:
- Përdorimi i shkronjave <i> dhe <h> si mjete grafike (sh. më poshtë).
  - Dyfishimi i bashkëtingëlloreve (për të shënuar edhe gjatësinë dhe intensitetin), khs.: <trettini>, <mott> etj.
  - Pikësimi është – sikurse pritet - i ndikuar tërësisht nga rregullat e drejtshkrimit të italishtes.
- c) Llojet e grafemave në tekst përkojnë gjithashtu me ato të shkrimit shqip në arealin kulturor fetar të Veriut. Ndër to dallojmë:
- Grafema të thjeshta njëvlerëshe, khs.: <8 ε f t> = /y, z, f, t/.
  - Grafema të përbëra (digrame) njëvlerëshe, khs.: <ξξ aa gn> = /th, ā, nj/.
  - Grafema të thjeshta shumëvlerëshe (= me distribucion në varg), khs.: <c-A ~ c-E> = /k/ ~ /ç/.
  - Gërmat majuskula: jo vetëm në fillim fjalie dhe për emra të përveçëm, por edhe për institucione dhe/ose nocione themelore teologjike e të ngjashme me to, khs.: <Tineεot> = *Tinëzot*, <Meemetit i Marturit> = *Mëmetit i Marturit* pranë <Laft> = *Laft* “lavd”, <Mpereti> = *mpëreti* “mbreti” etj.

### 3.2. Kodi alfabetik i tekstit shqip

Më poshtë po paraqesim në mënyrë tabelare kodin alfabetik të zbatuar në tekst.

#### a. Tingujt zanorë:

IPA	Kodi i letrës 1761	Alfabeti i Manastirit	Shembuj nga teksti	Gjegjësit e transkriptuar
[a]	<a>	<a>	ka ξan, bane, Dialin	ka than, bane, dialin
[a:]	<aa>		Giaa, paa, ke me paam	xhā, pā, ke me pām
[e]	<e>	<e>	se, me guzuem, e, jeta	se, me guxuem, e, jeta
[e:]	<ee>		ndeer, feen, sperbleem	ndēr, fēn, shpërblēm
[ə]	<e>	<ë>	(kete, per, te, kessai)	(ketë, për, të, kësaj)
[o]	<o>	<o>	Mos, na prove, na more	mos, na prove, na more
[i]	<i>	<i>	ichini, trettini, ci, kemi	ikini, tretini, ç, kemi
[i:/i:]	<ii/ij>		miir, sctijne, lijruem	mīr, shṫīnë, līruem
[y]	<8>	<y>	{ot8n, t’at8ne, Kr8et	Zotyn, t’atyne, kryet
[y:]	<88>		per/me t88	për/me tṫ
[u]	<u/v>	<u>	Giuna, pluhen, vne	xhuna, pluhen, une
[u:]	<uu>		per iuu, te tuu	për jū, te jū

#### Vërejtje:

- Vërejmë paraprakisht që vlerësimi i shkronjës <e> në tekst është parë gjithkund në tekst vetëm me vlerën funksiondalluese të fonemës /e/. Mënjanimin e ndërhyrjeve *ad hoc* për të shënuar

tingullin Schwa [ə] (= “e-ja e pazanë”) në pozicion (vetëm) të patheksuar, e kemi mënjeluar për një arsye të thjeshtë: letërshkruesi nuk duhet të jetë shqipfolës.

- Në tekst arrijnë të izoloohen grafikiisht edhe zanoret e gjata, të cilat – siç pritet në çdo tekst me bazë dialektin e Veriut – janë të organizuara në një sistem më vete.
- Shkurtësia e tekstit nuk jep shkas për të diskutuar praninë apo mospraninë e zanores së gjatë <oo> = /ō/ në gjuhën e (mësuar të) autorit.
- Në tekst nuk ndeshim gjithashtu kurrfarë gjurmësh që përcjellin grafikiisht sistemin e zanoreve hundore të dialektit geg. Një konstatim i tillë e përforcon disi mendimin që letërshkruesi nuk është native speaker i hapësirës dialektore gege.

### b. Tingujt bashkëtingëllorë:

Alf. i Manas	IPA	Kodi i letrës	Shembuj nga teksti	Gjegjësit e transkriptuar
<p>	[p]	<p>	Mpereti, punuem	mpereti, punuem
<b>	[b]	<b>	bane, rob, na bien	bane, rob, na bien
<t>	[t]	<t>	Maumetit, Kr̄šet, ritt	Maumetit, kryet, ritt
<d>	[d]	<d>	nde, tande, Scendet	nde, tande, shendet
<k>	[k]	<k>	Bekchleuere, kie, ka	beklevere, kie, ka
		<c(h)>	curcusc, Monaficheue	kurrkush, monafikeve
<g>	[g]	<g>	guzuem, me v ngaam	guxuem, me u ngām
		<gh>	ndighiò	ndigio
<f>	[f]	<f>	feen, fai, fial, fal	fēn, faj, fjal, fal
<v>	[v]	<v>	Dovletin, na prove	Dovletin, na prove
		<u>	Bekchleuere	beklevere
<th>	[θ]	<ξξ>	Giξξere	xhithhere
<dh>	[ð]	<ξ>	ka ξan	ka than
<s>	[s]	<s>	Mos, se, s ka, bessen	mos, se, s’ka, besen
<z>	[z]	<ε>	εot̄ōn, Tineεot	Zotyn, Tinezot
<sh>	[ʃ]	<sc(i)>	Scendet, lesciona	shendet, leshona
		<s>	sperbleem, skon	shperblēm, shkon
<zh>	[ʒ]	----	(e padëshmuar)	-----
<c/x>	[ts/dz]	<z>	me guzuem	me guxuem
<ç>	[tʃ]	<cc(i)>	ci, cisc, facien, dacc	çi, çish, façen, daç
<xh>	[dʒ]	<g(i)>	giaa, Ogiakun, Giuna	xhā, oxhakun, xhuna
<h>	[h]	<h>	pluhēn	plunen
<j>	[j/ɹ]	<j>	jeta, Jemi, Jessem	jeta, jemi, jesem

		<i>	iam, iuu, fai, Dialin	jam, jū, faj, djalin
<m>	[m]	<m>	Maumetit, scium	Maumetit, shum
<n>	[n]	<n>	nde, bane, na, lutun	nde, bane, na, lutun
<nj>	[ɲ]	---	(e padëshmuar - ?)	----
<l>	[l]	<l>	fial, lutun, e Pulitit	fial, lutun, e Pulitit
<ll>	[ɫ]	---	(e padëshmuar)	----
<r>	[r]	<r>	rob, te miir, përpara	rob, të mīr, përpara
<rr>	[r]	(<r>)	(ritt, mer, curcusc)	(ritt, mer, kurrkush)

Vërejtje:

- Shkurtësia e tekstit nuk lejon identifikimin e gjithë fondit të tingujve bashkë-tingëllorë me vlerë kuptimdaluese (= të fonemave), si psh. /nj/, /zh/, /ll/, /c/.
- Mungesa të tjera mund dhe duhet të shpjegohen me vështirësitë e shkruarit të letrës si joshqipfolës, përkatësisht me rrafshimet me karakter analogjik nën ndikimin e sistemit fonetik të gjuhës së tij burimore. I tillë është për shembull thjeshtimi, përkatësisht mosdallimi i tingujve afrikatë /ç/, /xh/ me ata qiellzorë /q/, /gj/, khs. <Ogiakun> = /oxhakun/ kundrejt <giaa> = /xhā/ "gjë", <Giuna> = /xhuna/ "gjynah", <dogie> = /doxhe/ "dogje" (sh. më lart).
- Rrethana të ngjashme lejohej të përsiasim edhe ndaj mosdallimit grafik të bashkëtingëlloreve vibrante /r/ dhe /rr/, khs.: <rob>, <te miir> "të mirë", <përpara> kundrejt <ritt> "rittë", <mer> "merr", <curcusc> "kurrkush" etj.

#### 4. Trashëgim dhe risi gjatë përjasjes së kodeve alfabetike

##### 4.1. Përjasje me letrën e pleqve të Gashit (30 maj 1689)

Kodi alfabetik i përdorur në këtë letër përkon thuajse plotësisht me atë të zbatuar më se 70 vjet më parë në trojet më lindore të dioqezës së Pultit. Është fjala këtu për të ashtuquajturën letër e pleqve të Gashit më 30 maj 1689, që zbuloi dikur Peter Bartl po në fondet e arkivit historik të Propaganda Fide-s (shën. 39), khs.:

Alfabeti i Manastirit	API	Grafia e letrës së pleqve të Gashit 1689	Grafia e letrës së fretërve të Pultit 1761
a	[a] ~ [a:]	a ~ aa	a ~ aa
b	[b]	b	b
c (~ x)	[ts/dz]	(z)	z
d	[d]	d	d
dh	[ð]	ξ	ξ
e	[e] ~ [e:]	e ~ ee	e ~ ee

ë	[æ/ɜ/ə]	e	e
f	[f]	f	f
g	[g]	g-A	g-A, gh-E
gj (~ xh)	[j] (~ [dʒ])	g-E	g-i, gi-A/e
h	[h]	h	h
i	[i] ~ [i:]	i ~ ii/ij	i ~ ii/ij
j	[j]	i	i, j
k	[k]	k, c-A	k, -kch-, c-A, ch-E
l	[l]	l	l
ll	[ʎ]	l	(?)
m	[m]	m	m
n	[n]	n	n
nj	[ɲ]	gn	gn
o	[o] ~ [o:]	o (~ ?)	o (~ ?)
p	[p]	p	p
q (~ ç)	[ç] (~ [tʃ])	ch-i	c-E, -cc#
r	[r]	r	r
rr	([rr])	(?)	(?)
s	[s]	s, f, -ss-/fs-	s/f, -fs-
sh	[ʃ]	sc/fc-E/C, fci-A, s-	sc/fc-E, fci-A, s-
t	[t]	t, tt	t, tt
th	[θ]	θθ	θθ
u	[u] ~ [u:]	u, v ~ uu	u, v ~ uu
v	[v]	v, u	v, u
y	[y]	ɝ ~ ɝɝ	ɝ ~ ɝɝ
z	[z]	ε	ε

#### 4.2. Bashkëkohësi dhe traditë mes sistemeve bashkëkohore të shkrimit shqip

Në rast se përjasja e mësipërme dëshmon në një mënyrë a një tjetër një vazhdimësi në traditën e shkrimit shqip, këtë vazhdimësi jemi të detyruar qoftë edhe përkohësisht ta kufizojmë vetëm në hapësirën që mbulon zonën e dioqezës së Pultit me rrethina. Përjasje të tjera me ato pak tekste shqip që njohim deri sot për këtë periudhë, të tilla si: "Mallkimet e së Enjtes së Madhe" (pas gjase) me autor Pal Kamsin (Shkodër 1744)<sup>44</sup> dhe "Doktrina e Kërshten" e Gjon P. Nikollë Kazazit (Romë 1743)<sup>45</sup> faktësojnë qartas bashkëjetesën mes tri sistemesh të shkrimit shqip me alfabet latin në arealin kulturor të Shqipërisë së

44 Khs. tekstin te Nevila Nika: Dioqeza e Shkodrës gjatë shek. XVIII sipas dorëshkrimeve arkivore, Shkodër 2001, f. 132. Sh. edhe Dh. Shuteriqi: Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800, Tiranë 2005, f. 266v.

45 Sh. më hollësisht B.Demiraj: Gjon P. Nikollë Kazazi dhe doktrina e tij, Prishtinë 2006, f. 148vv. Sh. edhe më lart shën 43.

Veriut në gjysmën e shek. të 18-të.

Ndër këto variante, ai i përdorur nga Kazazi – me përhapje ndoshta vetëm në pjesën verilindore të këtij areali – përbën risinë e kohës në kulturën e shkrimit. Varianti i përdorur prej ipeshkvit të Shkodrës Pal Kamsi pasqyron vijimësi të pandërmjetshme të kodit alfabetik që përmirësoi dhe përdori Pjetër Bogdani (1685). Ndërsa hetimi në thellësi i gjurmëve të kodit alfabetik në tekstin tonë na lejon të mëtojmë se kemi të bëjmë me një vazhdimësi të drejtpërdrejtë të traditës më të hershme shkrimore që krijoi dhe përhapi në arealin kulturor të Shqipërisë së Veriut penda e Pjetër Budit.

### SUMMARY

This essay by Peter Bartl, a German historian and Bardhyl Demiraj, an Albanologist focuses on the so-called *Letter of Pulti Friars*, which is an important document of written Albanian of the second half of 18th century.

Bartl analyses the historical circumstances and the situation of the Catholic Church in the Diocese of Pulti, whereas Demiraj considers the linguistic peculiarity of the letter by comparing it with other similar documents of the same period.